



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2024:007360

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05556658

P.nr.03/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.T. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1622/23 e datës 05.01.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 03.04.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Ajtene Zoni dhe i pandehuri L.T., më dt.03.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 08.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

IPANDEHURI: L.T. nga i ati A., e ëma S., e gjinisë S., i lindur më datë ... në Vushtrri, ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon taksist në “B...” në Prishtinë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datën 20.03.2023, rreth orës 21:00, në Vushtrri, në rrugën “Avni Saraqi”, i pandehuri pa autorizim posedon substancë narkotike ashtu që, zyrtarët policor gjatë patrullimit në rrugën e lartcekur kanë ndaluar të pandehurin dhe me rastin e kontrollimit tek i pandehuri, në trupin e tij kishin gjetur një substancë narkotike e cila është sekuestruar dhe pas ekzaminimit në laborator të Forenzikës është konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis – marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 1.17 gram,

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 269 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPK-së, e

GJYKON

Të pandehurit: L.T. i shqipton DËNIM ME GJOBË në shumën prej gjashtë qind (600) euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Këtë dënim me gjobë të shqiptuar i akuzuari mund ta paguajë me tri (3) këste më së largu deri me datën 5 të muajit vijues dhe jo me vonë se 3 muaj nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Ne rast se i pandehuri refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis – marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 1.17 gram.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1622/23 e datës 05.01.2024, kundër të pandehurit L.T. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 03.04.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Ajtene Zoni si dhe i pandehuri L.T.. Gjatë kësaj seance prokurorja e shtetit ka bërë plotësimin e aktakuzës dhe atë sa i përket cilësimit të veprës penale dhe atë nga paragrafi 1 në paragrafin 2 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.03.04.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që: I pandehuri L.T. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i ka propozuar gjykatës që të merr parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raporti policor me numër të rastit 2023-BD-216 i datës 20.03.2023 nga zyrtari A.F., Dosja e Njësisë së Forenzikës e datës 20.03.2023, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 20.03.2023, Informacionet për të kaluarën kriminale e marr nga data baza e policisë së Kosovës, Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit L.T. i datës 20.03.2023 në Stacionin Policor në Vushtrri

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri nga me dashje ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 269, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen *“Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet..”*, ndërsa paragrafi 2 i nenit 269 të KPRK e për të cilin akuzohet i pandehuri parasheh se: *“Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.”*

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit,

bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, si dhe pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjësisë penale.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Konfiskimi i narkotikëve nga gjykata është bazuar në nenin 269 par 3 ku është përcaktuar se, *“Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.03/2024, datë 08.04.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.